



Pyetje dhe Përgjigje

Thirrja e dytë për propozime për grantet e vogla dhe mesme
për
Mbështetje të OSHC-ve në zbatim të projekteve në njërin nga tri fushat tematike:
Mbrojtja e Mjedisit, Energjia e Gjelbër dhe Ekonomia Qarkore

**“Empower – Engage – Build Ownership”
i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë**

Pyetja 1

A mund të hyjë në këtë grant prodhimtaria e kornetave të vezëve pasi që procesi i prodhimitarisë së kornetave shaktohet nga mbledhja e letrave në rajon që ndikon në mbrojtjen e Mjedisit.

Përgjigje 1

Po, me kusht që, ndër të tjera, të vlerësohet sasia e lirimit të gazërave serrë në këtë proces.

Pyetje 2

A lejohet që në grantin e mesëm të jenë bashkfinancues institucionet publike si p.sh komunat dhe a ka limit (vlerën minimale dhe maksimale) në përqindje të bashkfinancimit?

Përgjigje 2

Po, në grantin e mesëm lejohet që bashkëfinancues të jenë institucionet publike. Mirëpo, ju lutem vini re se burimet e bashkëfinancimit nuk mund të rrjedhin nga fondet e BE-së, drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Kurse vlera e përqindjes së bashkëfinancimit për grantin e mesëm është 20%. Pra, këtu hyn vlera e grantit të mesëm plus 20% bashkëfinancim i buxhetit të përgjithshëm.

Pyetje 3

Vlera e pajisjeve që ka në dispozicion një shoqatë a mund të llogaritet si bashkëfinancim?

Përgjigje 3

Jo, nuk lejohet që vlera e pajisjeve të llogaritet si bashkëfinancim.

Implementuar nga:



Pyetje 4

A kemi të drejtë që të aplikojmë me të njejtin projekt që kemi marrë grant nga ju, por që projekti të realizohet në komuna të tjera?

Përgjigje 4

*Aplikantët që kanë përfunduar me sukses kontratat nga Thirrja e Parë në kuadër të këtij projekti, kanë të drejtë të aplikojnë për këtë thirrje të dytë; me kusht që propozimi **NUK** është thjesht përsëritje e projektit të mëparshëm. Pra, idea duhet të jetë e re.*

Pyetje 5

Në lidhje me 20% të bashkëfinancimit që duhet mbuluar në kuadër të grantit të mesëm, a ka nevojë të dëshmohen këto shpenzime?

Përgjigje 5

Po, për çdo lloj shpenzimi duhet ofruar dëshmi për pagesën respektive. Duhet pasur parasysh që asnjë faturë nuk duhet të ketë të përfshirë TVSH-në. Pra, TVSH-ja nuk mbulohet nga projekti.

Pyetje 6

Çka janë, si llogariten dhe dëshmohen kontributet në natyrë? A mjaftojnë vetëm listat e pjesëmarrësve nëse kontributi në natyrë është në formë të mbajtjes së punëtorisë, ligjeratave dhe të ngjajshme?

Përgjigje 6

Kontributet në natyrë janë shërbime dhe mallra ekuivalente me para të gatshme, të cilat nuk faturohen – pra është shërbim i marrë pa kosto në kuadër të projektit.

Kontributet në natyrë duhet të mirëmbahen njësoj sikurse po të buxhetohej shërbimi në fjalë, mirëpo duhet cekur se është shërbim i marrë pa kosto në kuadër të projektit. Kurse për çdo kontribut nga një person fizik, duhet pasur kontratë të përpiluar që detajon përgjegjësitë e individit në fjalë.

Implementuar nga:



Pyetje 7

A mund të aplikohet për grant për mbështetje të një aktiviteti/eve në kuadër të një Panairit që mbahet për tri ditë, por faktikisht periudha e organizimit/ implementimit është 10-12 muaj?

Përgjigje 7

Po, me kusht që, ndër të tjera, aktivitetet e Panairit ndërlidhen me njërën nga tri çështjet tematike të këtij projekti: Mbrojtja e mjedisit, Energjia e gjelbër, rritja ekonomike e qëndrueshme/Ekonomia qarkore.

Pyetje 8

A mund të përfitoj përkrahje kompania e cila bën prodhimin e kërpurdhave duke ricikluar mbetjet e kafës?

Përgjigje 8

Po, me kusht që, ndër të tjera, të vlerësohet sasia e lirimt të gazërave serrë në këtë proces.

Pyetje 9

A mund të aplikohet si Komunë për ndarjen e granteve nga ana juaj në fushën e Mjedisit?

Përgjigje 9

Institutionet publike, në këtë rast Komunitat, nuk mund të jenë përfituese direkt nga kjo Thirrje për Propozime.

Pyetje 10

Për grante të mesme, a bën që bashkëfinancimi të jetë 'puna e papaguar' e menaxherit të projektit me një pjesëmarrje prej 20% e cila i bie të jetë në një formë kontribut në natyrë?

Përgjigje 10

Po, mundet që rroga të përfshihet në 20% që duhet të jetë kontribut në natyrë. Mirëpo, duhet përpiluar një kontratë për personin në fjalë që detajon përgjegjësitë si dhe shumën e saktë që përputhet në total me vlerën e 20% të lartëcekur.

Kontributet në natyrë duhet të mirëmbahen njësoj sikurse po të buxhetohej shërbimi në fjalë, mirëpo duhet cekur se është shërbim i marrë pa kosto në kuadër të projektit.

Implementuar nga:



Balkan Green Foundation

